

Dt.12.12.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Qeramarrje mjeti transporti për Këshillin Bashkiak”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34115200-8; 98390000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: **1.083.336 (një milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh**, me objekt: **“Qeramarrje mjeti transporti për Këshillin Bashkiak”**, vënë në dispozicion me anë të V.K.B-së Nr. 125 dt 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”, i ndryshuar.

**Kohëzgjatja në muaj:** (njëzet e katër) muaj nga dita e dorëzimit të mjetit në Bashkinë Tiranë. (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër

Afati i levritimit të mjeteve 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, termat e leasing 24 (njëzet e katër) muaj.

Nga data e nënshkrimit të kontratës operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe në datat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor, brenda 15 ditë pune.

**Lloji i Marrëveshjes Kuadër do të jetë me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloji Marrëveshje Kuadër**

*1. Bazuar në Nenin 61 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur, siç është rasti i “Qeramarrje mjeti transporti për Këshillin Bashkiak” (1 mjet transporti). Gjithashtu kjo zgjedhje e marrëveshjes kuadër me 1 Operator ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për këtë procedurë prokurimi, është se objekti i prokurimit parashikon një shërbim periodik dhe të vazhdueshëm dhe për këtë arsye realizimi i shërbimit nga operatorë ekonomik të ndryshëm nuk është i favorshëm duke i shkaktuar vështirësi autoritetit kontraktor. Bazuar dhe në rekomandimet e APP-së, është përzgjedhur lloji i Marrëveshjes Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.*

*Kryerja e shërbimit të kërkuar nga AK nga operatorë të ndryshëm ekonomikë nuk do të ishte i favorshëm, pasi do të shoqërohej me kosto shtesë dhe vonesa të shërbimit objekt prokurimi, për kryerjen e procedurave të minikonkurimit nga AK, palë e kësaj MK duke shkaktuar vështirësi në realizimin e shërbimit në rast vonese të ofrimit të shërbimit.*

*2. Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE ku të gjitha kushtet nuk janë të përcaktuara do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të kryerjes së shërbimit.*

*3. Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për realizimin e shërbimit në kohën e kërkuar nga AK.*

*Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështime në realizimin e shërbimit duke rrezikuar dhe mos realizimin në kohë të kontratës.*

*Me qëllim garantimin e kryerjes së shërbimit në afatet kohore të përcaktuara për AK përfitues MK me një OE të vetëm do të garantonte sigurinë e kryerjes së shërbimeve kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c

dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe në mbeshtetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik(i ndryshuar): citojmë Neni 83 i LPP(I ndryshuar) “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP (i ndryshuar) “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

### **Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP(i ndryshuar), nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 9 të DST-së.*

### **2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar e kontratës që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur edhe nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

*.Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë*

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pika 2 (a) konkretisht:

“ *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

- a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

**2.2.2** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

\*\*\* *Kriteri 2.2.2 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP(i ndryshuar), nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.*

*Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40/4, 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*

*“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/ fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë se merr përsipër përbushjen e kërkesave të AK sipas përcaktimeve në shtojcën 6 dhe 7 të DST.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 1/c dhe pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar, kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të mjetit të ofertuar me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor.. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duke qenë se projekti në vetëvete është një projekt TIK, nisur nga termat e referencës dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf të diplomuar/ certifikuar në degët/ fushat e sipërpërmendura, për të cilat kërkohet niveli i tyre profesional lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të

argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

## **Specifikime teknike**

- **Mjeti që do të ofrohet të plotësojë kërkesat sipas specifikimeve si më poshtë:**

*Me lëndë djegëse naftë.*

*Fuqia e motorit: 136 kuaj fuqi*

*Cilindrata: 1600 cc*

*Kambio automatike*

*Viti prodhimit të jetë: jo më parë se viti 2018*

*Nr. i dyerve: 4+1*

*Nr. Vendeve: 4+1*

*Kontrolli: automatik i dritave*

*Airbag: 4*

*Timoni: multifunksional*

*Radio: me AUX dhe Usb*

*Xhamat: elektrikë*

*Të jetë e shoqëruar me pajisje sipas Kodit Rrugor: Kutia e ndihmës së shpejtë, trekëndësh emergjence, jelek fosforeshent etj.*

*Mbyllja: qëndrore me pult*

*Km të kryer: max 70000 KM*

### ***Të tjera***

*Afati dorëzimit: 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës*

*Të ndërrohen gomat çdo 40.000 km*

*Asistencë teknike 24 orë/7 ditë.*

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

### **Shoqëritë ofertuese duhet të përmbushin këto kushte:**

*Menaxhimi i gjithë dokumentacionit të makinës përfshirë lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollin teknik vjetor etj.*

*Menaxhimi i gjithë procesit të sigurimeve përfshirë asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit.*

*Menaxhimin e ripërtëritjes së përvitshme të dokumentave shtetërore dhe teknike.*

*Kryerjen e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve.*

*Kryerjen e riparimeve jo rutinë në rast nevojë.*

*Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose më të mira)*

*Menaxhim flote me anë të inkorporimit të sistemit GPS.*

*Të marrë masa për zëvendësimin e automjetit deri në riparimin final në rast defekti.*

*\* Në respektim të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.*

**II. Argumentimi i specifikimeve teknike:** Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurrohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 5 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Grupi i punës i ngritur

*me Urdhër të Titullarit gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike i është referuar të dhënave teknike të llojit të mjeteve “Autovetura” që ofrohen në tregun vendas si dhe përvojave të mëparshme të AK-së. Përlllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit u konkludua nëpërmjet studimit të tregut të kryer nga Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, sipas çmimit të ofertuar për mjet/qera mujore, nga OE që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet. Kërkesa për qeramarrje mjeti për përdorim të Këshillit Bashkiak, vjen si rezultat i nevojës së Këshillit Bashkiak të Tiranës në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në agjendën e Këshillit Bashkiak në kuadër të aktiviteteve të planifikuara, sipas miratimit dhe detajimit të buxhetit referuar nevojave për shpenzime operative të Këshillit Bashkiak në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Rregulloren e Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe akteve të tjera ligjore.*

*Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Qeramarrje mjeti transporti për Këshillin Bashkiak”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.*

#### **Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

*Dokumentat e tenderit*

#### **NJËSIA E PROKURIMIT**